



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Prave – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Kancelarija Ministra Prave – Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 29/2024

Datë: 16/02/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me Rregulloren QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (Shtojca 1, pika 3), Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin dhe finalizimin e projekt-akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, si në vijim:
  - 1.1. Projekt Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe funksionimin e grupit koordinues ndërministror;
  - 1.2. Projekt Rregullore për mekanizmat koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjinore;
  - 1.3. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e mirëmbajtjes, sigurisë dhe përdorimit të sistemit dhe nxjerrjen e raporteve publike duke siguruar konfidencialitetin për viktimën;
  - 1.4. Projekt Udhëzim Administrativ për krijimin e fondit emergjent për nevojat e viktimave gjatë periudhës kur ata/ato janë në polici;
  - 1.5. Projekt Udhëzim Administrativ për linjën telefonike urgjente për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;

1.6. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat e shpërndarjes, monitorimit, licencimit dhe financimit të strehimoreve të specializuara për strehimin e viktimave të dhunës;

1.7. Programi për procedurat standarde të veprimit.

2. Grupi punues nga pika 1 e këtij vendimi përbëhet nga:

- 2.1. Anita Kalanderi, Ministria e Drejtësisë, Kryesuese;
- 2.2. Feride Podvorica, Ministria e Drejtësisë, Zv. Kryesuese;
- 2.3. Nazlie Bala, Ministria e Drejtësisë, anëtare;
- 2.4. Vlora Limani Hajnuni, Ministria e Drejtësisë, anëtare;
- 2.5. Alberita Hyseni, Zyra Ligjore/ ZKM, anëtare;
- 2.6. Florian Krasniqi, gjyqtar, anëtar;
- 2.7. Luljeta Bilalli, Prokurore, KPK, anëtare;
- 2.8. Arlinda Alshiqi – Lladrovci, Departamenti Ligjor/MD, anëtare;
- 2.9. Florentina Beqiraj, Njësia për të Drejtat e Njeriut/MD, anëtare;
- 2.10. Burhan Maxhuni, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, anëtar;
- 2.11. Luljeta Limani, Policia e Kosovës, anëtare;
- 2.12. Venera Dibra, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
- 2.13. Bahrije Berisha, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
- 2.14. Luljeta Ibishi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
- 2.15. Nazmije Kajtazi, Ministria e Shëndetësisë, anëtare;
- 2.16. Azize Sekiraqa, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
- 2.17. Blerta Dibrani, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtare;
- 2.18. Luljetë Hetemi, Akademia e Drejtësisë, anëtare;
- 2.19. Leonora Selmani, Agjencia për Barazi Gjinore, anëtare;
- 2.20. Elbasan Hoti, Qendra për Punë Sociale, anëtare;
- 2.21. Erblina Dinarama, Strehimoret, anëtare;
- 2.22. Adile Shaqiri, Departamenti për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, anëtare;

3. Pjesë e grupit punues ftohen edhe përfaqësues nga:

- 3.1. Ambasada Amerikane/OPDAT;
- 3.2. Rrjeti i Grave të Kosovës;
- 3.3. Qendra për Studime Gjinore;
- 3.4. OSCE;

4. Gjatë hartimit të projekt-akteve nënligjore, Grupi Punues duhet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Kosovës dhe legjislacionit përkatës në fuqi për hartimin e legjislacionit.

5. Sipas nevojave të Grupit Punues për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe përfaqësues të tjerë nga institucionet publike dhe shoqëria civile.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.